



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË  
DREJTORIA E PROGRAMEVE TË ZHVILLIMIT NË FUSHËN  
E MINIERAVE DHE INDUSTRIJË

Nr. 1490/1 Prot.

Tiranë, më 04.032024

Lënda: Njoftim për fillimin e procedurave për revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1939, datë 18.10.2022.

**SHOQËRISË “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” SH.P.K**

Rr. “Reshit Petrela”, Kompleksi Usluga, kati 8, Tiranë.

Për dijëni: **AGJENCISË KOMBËTARE TË BURIMEVE NATYRORE**  
Blloku “Vasil Shanto”, Nr.18, Tiranë.

**AUTORITETIT KOMBËTAR PËR SIGURINË DHE EMERGJENCAT NË  
MINIERA**

Rruga “Lord Bajron”, Laprakë, Tiranë.

Shoqëria “ALKO IMPEX GENERAL CONSTRUCTION” sh.p.k, është zotëruese e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1939, datë 18.10.2022, për mineralin gëlqeror, në Objektivin “Zall Herr”, Bashkia Kamëz, Qarku Tiranë.

Nga struktura përgjegjëse, Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore, me shkresën Nr. 1103, datë 08.02.2024, protokolluar në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë me Nr. 1490 Prot., datë 12.02.2024, është propozuar revokimi i Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1939, datë 18.10.2022, për mineralin gëlqeror, në Objektivin “Zall Herr”, Bashkia Kamëz, Qarku Tiranë, pasi nuk ka respektuar kërkesat e legjislacionit minerar, lidhur me pagesën e garancisë financiare të rehabilitimit të mjedisit për vitin 2023.

Propozimi i Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, është i mbështetur në Nenin 47, pika 1, gërma “ç” të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Sa më sipër, në zbatim të Nenit 48, të Ligjit Nr.10304, datë 15.07.2010, “Për Sektorin Minerar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, **ju njoftojmë për fillimin e procedurave të revokimit për Lejen Minerare të Shfrytëzimit** Nr.1939, datë 18.10.2022, për mineralin gëlqeror, në Objektivin “Zall Herr”, Bashkia Kamëz, Qarku Tiranë, që shoqëria Juaj zotëron.

Referuar pikës 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", keni të drejtë që, brenda 30 ditëve kalendarike nga data e njoftimit, sipas kushteve të paragrafit të mësipërm, të paraqesë sqarime për shkaqet e përmendura në njoftim për fillimin e procedurave të revokimit të lejes minerare.

Ju bëjmë me dije se, Ministri, do të marrë vendim mbi revokimin e Lejes Minerare të Shfrytëzimit Nr.1939, datë 18.10.2022, për mineralin gëlqeror, në Objektivin "Zall Herr", Bashkia Kamëz, Qarku Tiranë, 30 ditë kalendarike pas kalimit të afatit të përcaktuar në pikën 2, neni 48 "Procedura e revokimit të lejes", të ligjit Nr. 10 304, datë 15.07.2010 "Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin!

**MINISTRI  
BELINDA BALLUKU**

**ME AUTORIZIM  
ZËVENDËSMINISTRI  
ENKELEIDA MUÇAJ**

